



**Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)**

**Studimi Ndërkombëtar mbi Mësimdhënien dhe të Nxënit  
(TALIS) 2024**

## **Pyetësoni për drejtorin**

Versioni i studimit kryesor

Gjuha standarte shqipe

TALIS 2024 është një sondazh ndërkombëtar, i cili për zgjedh një kampion përfaqësues të përbërë nga mësues dhe drejtues shkolle, të cilët i nënshtrohen një instrumenti anketues lidhur me kushtet dhe mjedisin e procesit të mësimdhënie-nxënies. TALIS synon të sigurojë një informacion të vlefshëm, në kohë dhe të krahasueshëm mbi burimet arsimore për të ndihmuar vendet pjesëmarrëse të rishikojnë dhe përcaktojnë politika për zhvillimin e një arsimit cilësor në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë.

**Konsorciumi Ndërkombëtar**

Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Arritjeve Arsimore (IEA), Holandë dhe Gjermani

Këshilli Australian për Kërkime Arsimore (ACER), Australia

RAND Evropë, Mbretëri e Bashkuar

cApStAn Kontrolli i Cilësisë Gjuhësore, Belgjikë

---

## PQ\_Introduction\_sq-AL

### **Rreth TALIS 2024**

Studimi i katërt Ndërkombëtar për Mësimdhënien dhe të Nxënit (TALIS 2024) është një sondazh ndërkombëtar që u ofron mundësinë mësuesve dhe drejtuesve të japin kontributin e tyre në analizën e arsimit dhe zhvillimin e politikave arsimore. TALIS zhvillohet nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Shqipëria, së bashku me më shumë se 50 vende të tjera, merr pjesë në këtë sondazh.

Krahasimet ndërkombëtare nga TALIS do t'u mundësojnë pjesëmarrësve në sondazh të identifikojnë sfidat e përbashkëta dhe të mësojnë nga qasjet e politikave të vendeve të tjera. Drejtorët dhe mësuesit e shkollave do të japin informacione për çështje të tilla si: arsimi dhe zhvillimi profesional i tyre, praktikat e tyre profesionale dhe pedagogjike, perceptimet për profesionin, mjediset institucionale dhe menaxhimi, si dhe për çështje të tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me diversitetin dhe paanshmërinë, të nxënit social dhe emocional të nxënësve, përdorimin e teknologjisë në arsim dhe edukimin për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke qenë një sondazh ndërkombëtar, është e mundur që disa pyetje të mos jenë shumë të përshtatshme për situatën në vendin tuaj. Në këto raste, ju lutemi përgjigjuni sa më mirë që të mundeni.

### **Kofidencialiteti**

Të gjitha informacionet e mbledhura në këtë studim do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Ndërsa rezultatet do të vihen në dispozicion sipas vendit dhe, për shembull, sipas llojit të shkollës në një vend, ju garantoheni që as ju, as shkolla dhe asnjë nga personeli i shkollës nuk do të identifikoheni në asnjë raport të hartuar me rezultatet e studimit. Pjesëmarrja në këtë pyetësor është vullnetare dhe çdo individ mund të tërhiqet në çdo kohë.

## **Informacion në lidhje me pyetësin**

- Ky pyetësor kërkon të mbledhë informacione mbi arsimin në shkollë dhe çështjet e politikave arsimore.
- Personi që e plotëson këtë pyetësor duhet të jetë drejtori i kësaj shkolle.
- Nëse nuk keni informacion për t'iu përgjigjur pyetjeve të veçanta, ju lutemi konsultohuni me persona të tjerë në shkollën tuaj.
- Për plotësimin e këtij pyetësi duhen mesatarisht 45-60 minuta.
- Kur pyetjet i referohen "shkollës suaj", me "shkollë" nënkuptohet: "institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet: arsim fillor, arsim i mesëm i ulët dhe arsim i mesëm i lartë".
- Udhëzimet për t'iu përgjigjur pyetjeve janë të shkruara me shkronja të pjerrëta.
- Shumicës së pyetjeve mund t'u përgjigjeni duke shënuar përgjigjen më të përshtatshme.
- Kur ta keni plotësuar këtë pyetësor, ju lutemi informoni kordinatorin e shkollës tuaj, përgjegjës për TALIS 2024.
- Kur të keni pikëpyetje për ndonjë aspekt të pyetësit ose nëse dëshironi më shumë informacione në lidhje me pyetësin ose studimin mund të na kontaktoni duke përdorur detajet e mëposhtme të kontaktit: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, sekretaria@ascp.edu.al

## **Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj!**

---

# PQ\_Headline\_Personal\_Background\_sq-AL

## Informacion mbi të dhënat personale

*Këto pyetje lidhen me ju, arsimimin tuaj dhe pozicionin tuaj si drejtor shkolle. Në përgjigje të pyetjeve, ju lutemi shënoni zgjedhjen e duhur ose jepni shifra aty ku është e nevojshme.*

---

### PQ\_01\_sq-AL

#### Çfarë gjinie jeni?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

☐ Femër

☐ Mashkull

☐ Tjetër

---

### PQ\_02\_sq-AL

#### Cila është mosha juaj?

*Ju lutemi shkruani një numër.*

vjeç

---

## PQ\_03\_sq-AL

**Cili është niveli më i lartë i arsimimit zyrtar që keni përfunduar?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

☐

Arsimi i mesëm i ulët

☐

Arsimi i mesëm i lartë

☐

Arsimi post-sekondar 1-vjeçar

☐

Arsimi post-sekondar 2-vjeçar

☐

Niveli "Bachelor" ose ekuivalent

☐

Niveli "Master" ose ekuivalent

☐

Niveli "Doktoraturë" ose ekuivalent

---

## PQ\_04\_sq-AL

## **Sa vite përvojë pune keni, pavarësisht nëse keni punuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme?**

*Mos përfshini asnjë periudhë të gjatë lejeje, siç është leja e lindjes për nënën/babanë.*

*Përvoja e punës mund të ndahet në disa kategori.*

*Ju lutemi shkruani një numër në çdo rresht. Shkruani 0 (zero), nëse nuk keni.*

*Ju lutemi bëni rrumbullakosjen në vite të plota.*

a) Vite që punoj si drejtor në këtë shkollë

b) Vjet që punoj si drejtor në total

c) Vite që punoj në role të tjera drejtuese në shkollë (mos përfshini vitet që keni punuar si drejtor)

d) Vite që punoj si mësues, në total (përfshini të gjitha vitet e mësimdhënies)

e) Vite që punoj në punë të tjera

---

## PQ\_05\_sq-AL

**A e keni aktualisht detyrimin për të dhënë mësim, pjesë të detyrës suaj si drejtor i kësaj shkolle?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Po, më shumë se 50% e orëve të mia të punës
  - ☐ Po, deri në 50% e orëve të mia të punës
  - ☐ Jo
- 

## PQ\_06\_sq-AL

**Cili është statusi juaj aktual i punësimit si drejtor në këtë shkollë?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Me kohë të plotë (më shumë se 90% e orëve të plota të punës)
- ☐ Me kohë të pjesshme (71-90% e orëve të plota të punës)
- ☐ Me kohë të pjesshme (50-70% e orëve të plota të punës)
- ☐ Me kohë të pjesshme (më pak se 50% e orëve të plota të punës)

---

## PQ\_07\_sq-AL

**A i përfshin elementët e mëposhtëm arsimimi ose formimi/trajnimi që keni përfunduar? Nëse po, ishte përpara apo pasi e morët pozicionin e drejtorit?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

	Përpara	Pas	Përpara dhe pas	Asnjëherë
a) Program ose kurs trajnimi për administrim shkolle ose për administrator	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Program ose kurs trajnimi/formimi për mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Trajnim ose kurs për drejtimin në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

---

## PQ\_08\_sq-AL

**A keni marrë pjesë në ndonjë prej aktiviteteve të mëposhtme të zhvillimit profesional të organizuara për ju si drejtor, gjatë 12 muajve të fundit?**



*Zhvillimi profesional përkufizohet si veprimtari që synon të zhvillojë aftësitë, njohuritë, ekspertizën profesionale të individit.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Po, fizikisht	Po, virtualisht ose online	Po, fizikisht dhe virtualisht/ online	Jo
a) Kurse/seminare/workshope për tema, metoda të mësimdhënies ose tema pedagogjike			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Kurse/seminare/ workshope për drejtimin në arsim			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Konferenca për arsimin ku mësuesit, drejtorët dhe/ose studiuesit paraqesin studimet e tyre ose diskutojnë çështje për arsimin			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Programe zyrtare të kualifikimit (p.sh., një program për marrjen e një kategorie)			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e) Vëzhgimi i kolegëve dhe/ose vetëvëzhgimi dhe trajnimi si pjesë e një marrëveshjeje zyrtare			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f) Rrjete profesionale formale ose informale të drejtorëve, të krijuara posaçërisht për zhvillimin e tyre profesional.			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

g) Veprimtaritë mësimore të vetë-inicuar

☐☐☐☐

h) Kurse/seminare/workshope mbi përgatitjen e një strategjie për përdorimin e burimeve dhe të mjeteve digjitale

☐☐☐☐

i) Të tjera

☐☐☐☐

---

## PQ\_09\_sq-AL

**A keni marrë pjesë në ndonjë prej aktiviteteve të mëposhtme të zhvillimit profesional të organizuara për ju si drejtor, gjatë 12 muajve të fundit?**

*"Qëndrueshmëria mjedisore" nënkupton plotësimin e nevojave themelore të së tashmes pa rrezikuar plotësimin e nevojave të brezave të ardhshëm. Ajo përfshin ruajtjen e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e sistemeve ekologjike të tokës. Ndryshimet klimatike janë një nga kërcënimet kryesore për qëndrueshmërinë mjedisore. Ndryshimet klimatike janë një nga kërcënimet kryesore të qëndrueshmërisë mjedisore.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Po

Jo

a) Njohuri dhe të kuptuarit rreth qëndrueshmërisë mjedisore

☐☐

- b) Mënyra për të përmirësuar praktikën e qëndrueshmërisë mjedisore të kësaj shkolle ose ndikimin ekologjik (p.sh. kursimi i energjisë dhe ujit, reduktimi i konsumit, riciklimi)

☐☐

- c) Mënyra për mbështetjen e mësuesve që të mësojnë nxënësit mbi qëndrueshmërisë mjedisore

☐☐

---

## PQ\_10\_sq-AL

**Për secilën nga fushat e renditura më poshtë, ju lutemi tregoni shkallën në të cilën keni nevojë aktualisht për veprimtari të zhvillimit profesional.**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjë nevojë  
aktualisht

Nivel i ulët nevojë

Nivel mesatar  
nevojë

Nivel i lartë nevojë

- a) Njohuri dhe të kuptuarit e zhvillimeve të reja në studimet dhe teoritë për drejtimin

☐☐☐☐

b) Njohuri dhe të kuptuarit e politikave aktuale kombëtare/vendore për arsimin

☐☐☐☐

c) Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e cilësisë së shkollës

☐☐☐☐

d) Hartimi i kurrikulës së shkollës

☐☐☐☐

e) Përgatitja e zhvillimit profesional për/me mësuesit

☐☐☐☐

f) Vëzhgimi i mësimdhënies në klasë

☐☐☐☐

g) Dhënia e feedback/komenteve

☐☐☐☐

h) Nxitja e barazisë dhe diversitetit

☐☐☐☐

i) Zhvillimi i bashkëpunimit mes mësuesve

☐☐☐☐

j) Menaxhimi i shkollës (p.sh., menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi financiar)

	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
k)	Zhvillimi i një strategjie për përdorimin e burimeve dhe të mjeteve digjitale për mësimdhënie			
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
l)	Njohuri dhe të kuptuarit rreth qëndrueshmërisë mjedisore			
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
m)	Promovimi i mirëqenies së stafit			
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

---

## PQ\_Headline\_School\_Background\_sq-AL

### Informacion mbi shkollën

---

## PQ\_12\_sq-AL

**Cila nga pikat e mëposhtme e përshkruan më mirë vendndodhjen e shkollës suaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Fshat ose zonë rurale (deri në 3.000 banorë)
- ☐ Qytet i vogël (3.001 deri 15.000 banorë)
- ☐ Qytet (15.001 deri 100.000 banorë)
- ☐ Qytet (100.001 deri 1.000.000 banorë)
- ☐ Qytet i madh (më shumë se 1.000.000 banorë)
- 

## PQ\_13\_sq-AL

**Sa për qind e financimit të përgjithshëm të kësaj shkolle për një vit shkollor vjen nga burimet e mëposhtme?**

*Ju lutemi shkruani një numër në secilin rresht (afërsisht).*

*Shkruani 0 (zero) nëse nuk ka asnjë.*

a) Buxheti i shtetit (ministria, bashkia, qarku)

%

b) Tarifat e nxënësve ose taksat për shkollën, të paguara nga prindërit ose nga kujdestarët.

%

c) Të tjera (p.sh. donacione, grante, mbledhje fondesh)

%

---

## PQ\_14\_sq-AL

### **A menaxhohet në mënyrë publike apo private kjo shkollë?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

Menaxhim publik

☐

*Kjo është një shkollë e menaxhuar nga një autoritet arsimor publik, agjenci qeveritare, bashki, ose bord drejtues i emëruar nga qeveria ose i zgjedhur me ekskluzivitet publik.*

Menaxhim privat

☐

*Kjo është një shkollë e menaxhuar nga një organizatë joqeveritare; p.sh., një kishë, sindikatë, biznes ose institucion tjetër privat.*

---

## PQ\_15\_sq-AL

### **Për secilin nga pozicionet e renditura më poshtë, ju lutemi shkruani numrin e personelit (numrin e përgjithshëm) që punon aktualisht në shkollën tuaj.**

*Personeli mund të ndahet në kategori të ndryshme. Përfshi personelin e përkohshëm dhe personelin e punësuar nëpërmjet një kontraktori.*

*Ju lutemi shkruani një numër në secilin rresht. Shkruani 0 (zero) nëse nuk ka asnjë.*

- a) Mësues, pavarësisht klasave/moshave ku japin mësim  
*Ata mësues që veprimtarinë kryesore në shkollën tuaj, kanë ofrimin e mësimdhënies tek nxënësit.*

☐

- b) Personeli për mbështetje pedagogjike, pavarësisht klasave/moshave që mbështesin  
*Përfshihen të gjithë mësuesit ndihmës ose profesionistët e tjerë jo mësimdhënës që ofrojnë mësimdhënie ose mbështesin mësuesit në ofrimin e mësimdhënies, specialistët e kurrikulës, specialistët e medias për arsimin, psikologët, terapistët dhe infermierët.*

☐

- c) Personeli administrativ i shkollës  
*Përfshihen recepsionistët, sekretarët, punonjësit e financës dhe asistentët e administratës.*

☐

- d) Personeli për menaxhimin e shkollës  
*Përfshihen drejtorët, nëndrejtorët dhe personel tjetër menaxhues aktiviteti kryesor i të cilëve është menaxhimi.*

☐

- e) Personel tjetër (p.sh. në mensë, pastrim, teknikë ose roje).

☐



**Ju lutemi shënoni numrin e personelit (numri i përgjithshëm) në shkollën tuaj, për secilën prej kategorive më poshtë.**

*Përfshini personelin me kohë të pjesshme dhe personelin që filloi punë gjatë këtij viti.*

*Numëroni të gjithë pjesëtarët e personelit, përfshirë ata që dolën në pension, janë me leje lindjeje dhe mësues të përkohshëm.*

*Ju lutemi shkruani një numër në secilin rresht. Shkruani 0 (zero) nëse nuk ka asnjë.*

a) Mësues që filluan punë në këtë shkollë gjatë 12 muajve të fundit.

b) Mësues që u larguan përgjithmonë nga kjo shkollë gjatë 12 muajve të fundit.

c) Mësues që mungonin ose nuk ishin të disponueshëm për mësimdhënie në të martën e fundit që shkolla ishte e hapur.

---

**PQ\_17\_sq-AL**

**A ofrohen nivelet arsimore dhe/ose programet e mëposhtme në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shkruani një zgjedhje në çdo rresht.*

	Po	Jo
a) Arsimi parashkollor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Arsimi fillor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Arsimi i mesëm i ulët, programe të arsimit të përgjithshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Arsimi i mesëm i ulët special, programe të formimit profesional ose teknik, ose arsimi me kohë të pjesshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e) Arsimi i mesëm i lartë, programe të arsimit të përgjithshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f) Arsimi i mesëm i lartë, programe të formimit profesional, social-kulturor ose teknik ose me kohë të pjesshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Cila është situata aktuale e regjistrimit në shkollë, d.m.th., numri i nxënësve të të gjitha klasave/moshave në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shkruani një numër.*

Nxënës

---

## PQ\_19\_sq-AL

**Sa shpesh merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm kur nxënësit pranohen në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjëherë

Ndonjëherë

Shumicën e kohës

Gjithmonë

a) Banimi në një zonë të caktuar

☐☐☐☐

b) Notat e nxënësve (përfshirë rezultatin e testit në hyrje)

☐☐☐☐

c) Rekomandimi i shkollës nga vjen

☐☐☐☐

d) Miratimi i prindërve për filozofinë e mësimdhënies ose për filozofinë fetare të shkollës

☐☐☐☐

e) Nëse nxënësi kërkon ose është i interesuar në një program të posaçëm

☐☐☐☐

f) Preferencë u jepet pjesëtarëve të familjeve të nxënësve aktualë ose të mëparshëm

☐☐☐☐

g) Situatat emergjente (p.sh., konflikte, fatkeqësi natyrore, kriza të lidhura me shëndetin)

☐☐☐☐

---

## PQ\_20\_sq-AL

**Cila është politika e shkollës suaj për organizimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi ndryshe?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Për asnjë lëndë

Për disa lëndë

Për të gjitha lëndët

a) Nxënësit grupohen sipas aftësive në klasa të ndryshme.

☐☐☐

b) Nxënësit grupohen sipas aftësive brenda klasës së tyre.

☐☐☐

---

## PQ\_21\_sq-AL

**Ju lutemi vlerësoni përqindjen e gjerë të nxënësve të arsimit të mesëm të ulët në shkollën tuaj që kanë karakteristikat e mëposhtme.**

*Nxënësit mund të ndahen në kategori të shumta.*

*"Nxënës me nevoja të veçanta arsimore" janë ata për të cilët është identifikuar zyrtarisht një nevojë e veçantë arsimore për shkak se ata kanë probleme të shëndetit mendor, fizik ose emocional. Shpesh për ta ofrohen burime të tjera shtesë, publike ose private (personel, burime financiare ose materiale) për të mbështetur arsimimin e tyre.*

*"Familje me probleme social-ekonomike" i referohet familjeve që u mungojnë nevojat thelbësore ose të mirat e jetës, të tilla si strehimi i përshtatshëm, ushqimi ose kujdesi shëndetësor.*

*"Grupe etnike, pakica kombëtare ose komunitete indigjene" iu referohet grupeve që janë rezultat i dinamikave historike dhe/ose karakteristikave të përbashkëta që u korrespondojnë vendndodhjeve gjeografike dhe origjinave të paraardhësve, traditave kulturore, besimeve fetare, normave sociale, trashëgimisë dhe gjuhës së përbashkët, dhe/ose statusit të imigrantit dhe kombësisë në origjinë.*

*"Një nxënës imigrant" është ai që ka lindur jashtë vendit. Një nxënës i tillë ka prindër që kanë lindur që të dy jashtë vendit.*

*"Refugjatë" janë ata që, pavarësisht statusit juridik, ikin në një vend tjetër duke kërkuar strehim si pasoje e luftës, shtypjes politike, persekutimit fetar ose një fatkeqësie natyrore.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht*

[illegible]

g) Nxënës që janë imigrantë ose me histori emigracioni (pa përfshirë refugjatët)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

h) Nxënës që janë refugjatë

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

---

## PQ\_Headline\_School\_Leadership\_sq-AL

### Lidershipi në shkollë

---

## PQ\_22\_sq-AL

### A ka kjo shkollë një Drejtor shkollë?

“Drejtoria e shkollës” i referohet një grupi, brenda shkollës, që ka përgjegjësi për drejtimin dhe menaxhimin e shkollës, në marrjen e vendimeve, të tilla si ato që përfshijnë mësimdhënien, përdorimin e burimeve, kurrikulën, vlerësimin dhe vendime të tjera strategjike që lidhen me funksionimin e përshtatshëm të shkollës.

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

☐ Po

☐ Jo

---

## PQ\_23\_sq-AL

**A janë aktorët e mëposhtëm të përfaqësuar në Drejtorinë e shkollës?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

	Po	Jo	Nuk përdoret
a) Drejtori	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Nëndrejtori	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Drejtori i financës (p.sh., financieri, punonjësi i thesarit)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Përgjegjësit e ekipeve kurrikulare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



e) Mësuesit

☐☐☐

f) Bordi drejtues i shkollës

☐☐☐

g) Prindërit ose kujdestarët

☐☐☐

h) Nxënësit

☐☐☐

i) Tjetër

☐☐☐

---

## PQ\_24\_sq-AL

**Kush ka përgjegjësi të rëndësishme për detyrat e mëposhtme në shkollën tuaj?**

*"Një përgjegjësi e rëndësishme" është ajo që tregon se luhet një rol aktiv në vendimmarrje.*

*Ju lutemi shënoni sa më shumë zgjedhje të përshtatshme në çdo rresht.*

Drejtori

Anëtarë të  
tjerë të  
Drejtorisë së  
shkollës

Mësues (jo si  
pjesë e  
Drejtorisë së  
shkollës)

Bordi drejtues  
i shkollës

ZVA/ DRAP  
/DPAP

a) Emërimi ose punësimi i mësuesve

☐☐☐☐☐

b) Pushimi ose pezullimi i mësuesve nga puna

☐☐☐☐☐

c) Përcaktimi i pagave fillestare të mësuesve, përfshirë vendosjen e shkallës së pagave

☐☐☐☐☐

d) Vendimi për rritjen e pagës së mësuesve

☐☐☐☐☐

e) Vendimi për ndarjen e buxhetit brenda shkollës

☐☐☐☐☐

f) Përgatitja e politikave dhe procedurave disiplinore për nxënësit

☐☐☐☐☐

g) Përgatitja e politikave për vlerësimin e nxënësve, përfshirë vlerësimet kombëtare

☐☐☐☐☐

h) Miratimi i pranimi të nxënësve në shkollë

☐☐☐☐☐

i) Zgjedhja se cilat materiale mësimore përdoren

☐☐☐☐☐

j) Vendimi për përmbajtjen e kurrikulës lëndore, përfshirë kurrikulën në nivel kombëtar

☐☐☐☐☐

k) Vendimi se cilat lëndë ofrohen

☐☐☐☐☐

---

## PQ\_25\_sq-AL

### Kush ka përgjegjësi të rëndësishme për detyrat e mëposhtme në shkollën tuaj?

*"Një përgjegjësi e rëndësishme" është ajo që tregon se luhet një rol aktiv në vendimmarrje.*

*Ju lutemi shënoni sa më shumë zgjedhje të përshtatshme në çdo rresht.*

Drejtori

Anëtarë të  
tjerë të  
Drejtorisë së  
shkollës

Mësues (jo si  
pjesë e  
Drejtorisë së  
shkollës)

Bordi i  
shkollës

ZVA/ DRAP/  
DPAP

a) Vendimi për përdorimin e burimeve dhe mjeteve digjitale për mësimdhënie

☐☐☐☐☐

b) Përmirësimi i praktikave të qëndrueshmërisë mjedisore ose ekologjike të kësaj shkolle (psh., kursimi i energjisë dhe i ujit, reduktimi i konsumit, riciklimi)

☐☐☐☐☐

c) Përcaktimi i politikave për diversitetin e nxënësve

☐☐☐☐☐

d) Përcaktimi i politikave për diversitetin e mësuesve

☐☐☐☐☐

e) Lehtësimi i veprimtarive për zhvillimin profesional të mësuesve për mbështetjen e zhvillimit social dhe emocional të nxënësve

☐☐☐☐☐

f) Përcaktimi i përparësive për përmirësimin e shkollës

☐☐☐☐☐

---

**PQ\_26\_sq-AL**

**Sa shpesh, mesatarisht, e shpenzoni kohën tuaj si drejtor për detyrat e mëposhtme në shkollën tuaj, gjatë gjithë vitit**

# shkollor?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjëherë  
ose  
pothuajse  
asnjëherë

Disa  
herë në  
vit

Më pak  
se një  
herë në  
muaj

Çdo  
muaj

Çdo javë

Çdo ditë

Disa  
herë në  
ditë

a) Detyrat dhe takimet e lidërshipt

*Përfshihen veprimtaritë për planifikim strategjik, lidërshipt dhe menaxhim, të tilla si zhvillimi i planeve për përmirësimin e shkollës, dhe për çështje të burimeve njerëzore dhe personelit, si punësimi i stafit*

☐☐☐☐☐☐☐

b) Detyrat dhe takimet për kurrikulën dhe mësimdhënien

*Përfshihen zhvillimi i kurrikulës, mësimdhënia, vëzhgimet në klasë, vlerësimi i nxënësve, mësuesit mentorë, zhvillimi profesional i mësuesve.*

☐☐☐☐☐☐☐

c) Ndërveprimet me mësuesit dhe me personelin

*Përfshihen dhënia e këshillave, komentet, vlerësimet, aktivitetet jashtë mësimdhënies.*

☐☐☐☐☐☐☐

d) Ndërveprimet me nxënësit

*Përfshihen këshillimi dhe bisedat jashtë aktiviteteve të strukturuar të të nxënësve, si dhe disiplina.*

☐☐☐☐☐☐☐

e) Ndërveprimet me prindërit ose kujdestarët

*Përfshihen ndërveprimet formale dhe joformale.*

☐☐☐☐☐☐☐

f) Ndërveprimet me komunitetin vendor dhe rajonal, biznesin dhe industrinë

☐☐☐☐☐☐☐

g) Detyrat e emergjencës  
*Përfshihen ndjekja e dëmtimeve në infrastrukturë, krizat në komunitet ose në nivel kombëtar.*

☐☐☐☐☐☐☐

h) Detyrat dhe takimet administrative  
*Përfshihen rregullore, raporte, buxheti i shkollës, përgatitja e orareve dhe e përbërjes së klasës, përgjigja ndaj kërkesave të ardhura nga punonjësit e arsimit në nivel rrethi, rajoni, shteti.*

☐☐☐☐☐☐☐

i) Tjetër

☐☐☐☐☐☐☐

---

**PQ\_27\_sq-AL**

**Ju lutemi tregoni sa shpesh keni marrë pjesë në veprimtaritë e mëposhtme në shkollën tuaj, gjatë 12 muajve të fundit.**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo resht.*

Asnjëherë ose  
rrallë

Ndonjëherë

Shpesh

Shumë shpesh

a) Bashkëpunova me mësuesit për zgjidhjen e problemeve të disiplinës në klasë.

☐☐☐☐

b) Vëzhgova mësimin në klasë.

☐☐☐☐

c) Iu dhashë komente mësuesve mbi bazën e vëzhgimeve të mia.

☐☐☐☐

d) Ndërmora veprime për të mbështetur bashkëpunimin mes mësuesve për zhvillimin e praktikave të reja të mësimdhënies.

☐☐☐☐

e) Ndërmora veprime për të garantuar që mësuesit të marrin përgjegjësi për përmirësimin e aftësive të tyre në mësimdhënie.

☐☐☐☐

f) Ndërmora veprime për të garantuar që mësuesit të ndjehen përgjegjës për rezultatet e të nxënit të nxënësve të tyre.

☐☐☐☐

g) Iu dhashë informacion për shkollën dhe performancën e nxënësit, prindërve ose kujdestarëve.

☐☐☐☐

h) Vlerësova procedurat dhe raportet administrative të shkollës.

☐☐☐☐

i) Zgjidha problemet e orarit mësimor në këtë shkollë.

☐☐☐☐

j) Bashkëpunova me drejtorët e shkollave të tjera për të sfiduar detyrat e pozicionit të punës.

☐☐☐☐

k) Punova për një plan për zhvillimin profesional në këtë shkollë.

☐☐☐☐

---

## PQ\_28\_sq-AL

**Ju lutemi tregoni sa shpesh keni ndërmarrë veprime që lidhen me fushat mëposhtme në shkollën tuaj, gjatë 12 muajve të fundit.**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjëherë ose  
rrallë

Ndonjëherë

Shpesh

Shumë shpesh

a) Mbështetja e integritit të burimeve dhe të mjeteve digjitale për mësimdhënie



☐☐☐☐

b) Mbështetja e diversitetit të nxënësve

☐☐☐☐

c) Mbështetja e diversitetit të mësuesve

☐☐☐☐

d) Përmirësimi i zhvillimit social dhe emocional të nxënësve në shkollën tuaj

☐☐☐☐

e) Përmirësimi i praktikave të qëndrueshmërisë mjedisore ose ekologjike të kësaj shkolle (psh., kursimi i energjisë dhe i ujit, reduktimi i konsumit, riciklimi)

☐☐☐☐

f) Mbështetja e mësuesve të interesuar për të dhënë mësim rreth ndryshimeve klimatike

☐☐☐☐

---

## PQ\_30\_sq-AL

**Jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme për mësuesit në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak dakord

Nuk jam dakord

Dakord

Plotësisht dakord

a) Mësuesit marrin role lidershipi në nxitjen e zhvillimit profesional të komunitetit.

☐☐☐☐

b) Mësuesit ndërmarrin dhe drejtojnë aktivitete bashkëpunuese.

☐☐☐☐

c) Mësuesit udhëheqin veprimtari për zhvillimin dhe rritjen profesionale kurdoherë që është e mundshme.

☐☐☐☐

d) Mësuesit marrin pjesë në aktivitete dhe në projekte jashtë procesit mësimor të shkollës.

☐☐☐☐

---

**PQ\_Headline\_Induction\_sq-AL**

**Orientimi, mentorimi dhe vlerësimi formal**

---

**PQ\_32\_sq-AL**

## Cilët mësues kanë akses në veprimtaritë e mëposhtme orientuese në shkollën tuaj?

*"Veprimtaritë orientuese" janë krijuar për të mbështetur përfshirjen e mësuesve të rinj në profesionin e mësuesit dhe për të mbështetur mësuesit me përvojë që janë të rinj në një shkollë.*

*Ato organizohen ose si "programe orientuese formale", të tilla si mbikëqyrje e rregullt nga drejtori, ngarkesë e ulët në mësimdhënie, marrëveshje formale mentorimi me mësuesit me përvojë etj., ose si "programe orientuese informale" që janë aktivitete të pastrukturuara ose të paplanifikuara që përfshijnë prezantime të përgjithshme për shkollën dhe punën, punë informale me kolegë të tjerë të rinj, një manual mirëseardhjeje etj.*

*"Mësues të rinj në mësimdhënie" nënkuptohen ata mësues që kanë më pak se një vit pune të paguar si mësues.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Të gjithë mësuesit e rinj në shkollën tuaj

Vetëm mësuesit e rinj në mësimdhënie

Asnjë

a) Në programin formal të orientimit

☐☐☐

b) Në programin informal të orientimit

☐☐☐

## Cilat nga veprimtaritë e mëposhtme përfshihen në orientimin e mësuesit në shkollën tuaj?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Po

Jo

a) Kurse/seminare/workshope të ndjekura fizikisht

☐☐

b) Kurse/seminare/workshope online

☐☐

c) Veprimtari online (p.sh., komunitetet virtuale)

☐☐

d) Mbledhje të planifikuara me drejtorin dhe/ose me mësuesit me përvojë

☐☐

e) Mbikëqyrja nga drejtori dhe/ose nga mësuesit me përvojë

☐☐

f) Lidhja në rrjet/bashkëpunimi me mësues të tjerë të rinj

☐☐

g) Mësimdhënie në grup me mësues me përvojë

	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h) Portofolët/ditarët/revistat	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i) Ngarkesa e reduktuar në mësimdhënie	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j) Prezantimi i përgjithshëm/administrativ	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## PQ\_34\_sq-AL

### A marrin pjesë mësuesit e shkollës tuaj në program mentorimi?

*"Mentorimi" përkufizohet si një strukturë mbështetëse në shkollat ku mësuesit më me përvojë mbështesin mësuesit me më pak përvojë. Kjo strukturë mund të përfshijë të gjithë mësuesit në shkollë ose vetëm mësuesit e rinj.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Po, por mund të marrin pjesë vetëm mësuesit që janë të rinj në mësimdhënie, d.m.th., që kanë më pak se një vit të paguar si mësues
- ☐ Po, mund të marrin pjesë të gjithë mësuesit që janë të rinj në këtë shkollë.
- ☐ Po, mund të marrin pjesë të gjithë mësuesit e kësaj shkolle.

- ☐ Jo, aktualisht nuk ka mundësi për pjesëmarrje në program mentorimi nga mësuesit e kësaj shkolle.
- 

## PQ\_35\_sq-AL

**A është lënda kryesore e mentorit e njëjtë me atë të mësuesit për të cilin është mentor?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Po, shumicën e kohës
- ☐ Po, ndonjëherë.
- ☐ Jo, rrallë ose asnjëherë.
- 

## PQ\_37\_sq-AL

**Sa shpesh vlerësohet mesatarisht performanca e secilit mësues në shkollën tuaj nga personat e mëposhtëm?**

*"Vlerësimi formal" përcaktohet si procedurë kur puna e mësuesit vlerësohet nga drejtori, një inspektor i jashtëm ose nga kolegët e tij/saj, (p.sh., si pjesë e sistemit formal të menaxhimit të performancës që përfshin një numër procedurash dhe kriteresh) sesa një qasje më informale (p.sh., përmes diskutimeve informale).*

*Nëse asnjë nga alternativat e përgjigjeve nuk pasqyron situatën në shkollën tuaj, ju lutemi zgjidhni alternativën që është më e afërta.*

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

	Asnjëherë	Më pak se një herë në vit	Një herë në vit	Dy ose më shumë herë në vit
a) Drejtori	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Anëtarë të tjerë të Drejtorisë së shkollës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Mentorët e caktuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Mësues (që nuk janë pjesë e Drejtorisë së shkollës)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e) Individë ose organe të jashtme (p.sh., inspektorë, përfaqësues të bashkisë, personel të zyrës arsimore të qarkut ose persona të tjerë jashtë shkolle)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## Kush i përdor llojet e mëposhtme të informacionit si pjesë të vlerësimit të performancës së mësuesve në shkollën tuaj?

*Ju lutemi shënoni sa më shumë zgjedhje të përshtatshme në çdo rresht.*

Individë ose organe të jashtme	Drejtori	Anëtarët e drejtorisë së shkollës	Mentorët e caktuar	Mësues të tjerë (që nuk janë pjesë e Drejtorisë së shkollës)	Nuk aplikohet në shkollën tuaj
a) Vëzhgimi i mësimdhënies në klasë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Përgjigjet e pyetësorit të nxënësve në lidhje me mësimdhënien	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Vlerësimi i njohurive të mësuesve për përmbajtjen	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Rezultatet e jashtme të nxënësve (p.sh., rezultatet e testimeve kombëtare)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e) Rezultatet në shkollë dhe në klasë (p.sh., rezultatet e performancës, rezultatet e projekteve, rezultatet e testimeve)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



f) Vetëvlerësimi i punës së mësuesve (p.sh., prezantimi i vlerësimit të një portofoli, analiza e mësimdhënies duke përdorur video)

☐☐☐☐☐☐

## PQ\_39\_sq-AL

**Ju lutemi tregoni sa shpesh ndodh secila prej pikave të mëposhtme, në shkollën tuaj, pas vlerësimit formal të performancës së mësuesit.**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjëherë

Ndonjëherë

Shumicën e kohës

Gjithmonë

a) Diskutohen me mësuesin masat për përmirësimin e dobësive në mësimdhënie.

☐☐☐☐

b) Përgatitet një plan zhvillimi/trajnimi.

☐☐☐☐

c) Vihen ndëshkime materiale të tilla si ulja e rritjes vjetore të pagës.

☐☐☐☐

d) Caktohet një mentor për të ndihmuar mësuesin të përmirësojë mësimdhënien e tij.

☐☐☐☐

e) Një ndryshim në përgjegjësitë e punës së mësuesit (p.sh., rritja ose pakësimi i ngarkesës mësimore të tij, i përgjegjësi administrative/ menaxheriale ose detyrave si mentor)

☐☐☐☐

f) Një rritje në pagën e mësuesit ose një pagesë e një bonusi financiar

☐☐☐☐

g) Një ndryshim në mundësinë për rritje në karrierë të mësuesit

☐☐☐☐

h) Pushimi nga puna ose mosrinovimi i kontratës së punës

☐☐☐☐

---

**PQ\_Headline\_School\_Climate\_sq-AL**

**Klima në shkollë**

---

# PQ\_40\_sq-AL

**Jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme, siç zbatohen në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak dakord

Nuk jam dakord

Dakord

Plotësisht dakord

- a) Kjo shkollë i ofron personelit mësimor, mundësi për të marrë pjesë aktive në vendimet e shkollës.

☐☐☐☐

- b) Kjo shkollë u ofron prindërve ose kujdestarëve, mundësi për të marrë pjesë aktive në vendimet e shkollës.

☐☐☐☐

- c) Kjo shkollë u ofron nxënësve mundësi për të marrë pjesë aktive në vendimet e shkollës.

☐☐☐☐

- d) Unë i marr vetë vendimet e rëndësishme.

☐☐☐☐

- e) Në shkollë ka një kulturë bashkëpunimi që karakterizohet nga mbështetja e ndërsjellë.

☐☐☐☐

f) Personeli i shkollës ndan të njëjtën filozofi të përbashkët për mësimdhënien dhe të nxënit.

☐☐☐☐

g) Kjo shkollë nxit personelin të udhëheqë nisma të reja.

☐☐☐☐

h) Mësuesit mund të mbështeten tek njëri-tjetri.

☐☐☐☐

---

## PQ\_41\_sq-AL

**Deri në çfarë mase zbatohen në shkollën tuaj pohimet e mëposhtme?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak

Disi

Mjaftueshëm

Shumë

a) Mësuesit i kuptojnë qëllimet e kurrikulës së shkollës.

☐☐☐☐

b) Mësuesit ia dalin me sukses të realizojnë kurrikulën e shkollës.

☐☐☐☐

c) Mësuesit kanë pritshmëri të larta për arritjet e nxënësve.

☐☐☐☐

d) Prindërit ose kujdestarët mbështesin arritjet e nxënësve.

☐☐☐☐

e) Prindërit ose kujdestarët përfshihen në aktivitetet e shkollës.

☐☐☐☐

f) Nxënësit kanë dëshirë të shkojnë mirë me mësimet në shkollë.

☐☐☐☐

g) Nxënësit i ngacmojnë shokët e tyre që shkëlqejnë në mësimet në shkollë.

☐☐☐☐

h) Shkolla bashkëpunon me komunitetin lokal.

☐☐☐☐

---

## PQ\_42\_sq-AL

**Në çfarë mase pengohet mundësia e shkollës tuaj për të ofruar mësimdhënie cilësore nga secila prej çështjeve të mëposhtme?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak

Disi

Mjaftueshëm

Shumë

a) Mungesa e mësuesve të kualifikuar

☐☐☐☐

b) Mungesa e mësuesve të aftë për mësimdhënie tek nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

☐☐☐☐

c) Mungesa e mësuesve të formimit profesional

☐☐☐☐

d) Mungesa ose numri i pamjaftueshëm i materialeve didaktike (p.sh., tekstet shkollore)

☐☐☐☐

e) Mungesa ose numri i pamjaftueshëm i burimeve dhe i mjeteve digjitale për mësimdhënie

☐☐☐☐

f) Akses i pamjaftueshëm në internet

☐☐☐☐

g) Mungesa ose numri i pamjaftueshëm i materialeve në bibliotekë

☐☐☐☐

h) Mungesa e personelit mbështetës

☐☐☐☐

i) Mungesa ose hapësira e pamjaftueshme për mësimdhënie (p.sh. klasat)

☐☐☐☐

j) Mungesa ose numri i pamjaftueshëm i infrastrukturës fizike (p.sh. mobiliet në klasë, ndërtesa e shkollës, ngrohja/ftohja dhe ndriçimi)

☐☐☐☐

k) Mungesa e mësuesve me aftësi në mësimdhënie për nxënësit në një mjedis shumëkulturore ose shumëgjuhësor

☐☐☐☐

l) Mungesa e mësuesve me aftësi në ofrimin e mësimdhënies për nxënësit nga familje me vështirësi social- ekonomike

☐☐☐☐

m) Mungesa ose numri i pamjaftueshëm i materialeve të nevojshme për trajnimin e aftësive profesionale

☐☐☐☐

n) Koha e shkurtër ose e pamjaftueshme në procesin e mësimdhënies

☐☐☐☐

o) Shërbime të pamjaftueshme (p.sh., uji i pijshëm, energjia elektrike dhe kanalizimet/higjiena)

☐☐☐☐

# PQ\_43 (Version A)\_sq-AL

## Sa shpesh ndodhin problemet e mëposhtme mes nxënësve në shkollën tuaj?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjëherë	Më pak se një herë në muaj	Çdo muaj	Çdo javë	Çdo ditë
-----------	----------------------------	----------	----------	----------

a) Vandalizmi dhe vjedhja

☐☐☐☐☐

b) Intimidimi ose bullizimi midis nxënësve (ose forma të tjera të abuzimit verbal) në mjediset e shkollës.

☐☐☐☐☐

c) Intimidimi ose ngacmimi në internet midis nxënësve (ose forma të tjera të abuzimit verbal)

☐☐☐☐☐

d) Dëmtimi fizik i shkaktuar nga dhuna mes nxënësve

☐☐☐☐☐

e) Intimidimi ose abuzimi verbal i mësuesve ose i stafit në mjediset e shkollës

☐☐☐☐☐



f) Intimidimi në internet ose abuzimi verbal i mësuesve ose stafit

☐☐☐☐☐

g) Përdorimi/zotërimi i drogave/alkoolit

☐☐☐☐☐

---

## PQ\_Headline\_Schooling\_Environments\_sq-AL

### Arsimimi në mjedise të larmishme

Seksioni i mëposhtëm përfshin pyetje mbi politikat dhe praktikat e shkollës në lidhje me diversitetin. "Diversiteti" i referohet njohjes dhe vlerësimit të ndryshimeve në situatat etnike, kulturore ose social-ekonomike, të identiteteve gjinore dhe të nevojave për të nxënit e nxënësve dhe të personelit.

---

## PQ\_45\_sq-AL

**A ka në shkollën tuaj nxënës nga prejardhje të ndryshme kulturore ose etnike?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

☐ Po

☐ Jo

---

## PQ\_46\_sq-AL

### **A zbatohen politikat dhe praktikat e mëposhtme për diversitetin në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Po

Jo

- a) Mbështetja e veprimtarive ose organizatave që nxisin shprehjen nga ana e nxënësve të identiteteve të larmishme etnike dhe kulturore (p.sh. grupet artistike)

☐☐

- b) Organizimi i veprimtarive shumëkulturore (p.sh., dita e diversitetit kulturor)

☐☐

- c) Mësimi i nxënësve si të trajtojnë diskriminimin etnik dhe kulturor

☐☐

d) Përdorimi i praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit që përfshijnë çështje globale në të gjithë kurrikulën

☐☐

e) Përfshirja e librave dhe fotove që përmbajnë njerëz nga grupime të ndryshme etnike dhe kulturore

☐☐

f) Punësimi i mësuesve që janë përfaqësues të grupimeve të ndryshme të nxënësve dhe/ose familjeve të tyre

☐☐

g) Ofrimi i mbështetjes shtesë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

☐☐

h) Mësimi i nxënësve që të jenë gjithëpërfshirës dhe të përfshijnë nxënës të niveleve të ndryshme social-ekonomike

☐☐

i) Politika të qarta kundër diskriminimit gjinor

☐☐

j) Politika të qarta kundër diskriminimit social-ekonomik

☐☐

k) Mbështetje shtesë për nxënësit nga grupe të disavantazuara

☐☐

l) Nxitja e një klime të sigurt në shkollë për nxënës me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet të ndryshëm gjinor

☐☐

## PQ\_47\_sq-AL

**Sipas mendimit tuaj, afërsisht sa mësues në shkollën tuaj do të ishin dakord me pohimet e mëposhtme?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Asnjë ose  
pothuajse asnjë

Disa

Shumë

Të gjithë ose  
pothuajse të  
gjithë.

a) Është e rëndësishme të jemi të përgjegjshëm ndaj niveleve të ndryshme kulturore të nxënësve.

☐☐☐☐

b) Është e rëndësishme për nxënësit të mësojnë se njerëzit nga kultura të tjera, mund të kenë vlera të ndryshme.

☐☐☐☐

c) Respektimi i kulturave të tjera është diçka që fëmijët dhe të rinjtë duhet ta mësojnë sa më herët të jetë e mundur.

☐☐☐☐

d) Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mësojnë që njerëzit nga kultura të ndryshme kanë shumë gjëra të përbashkëta.

☐☐☐☐

e) Shkollat duhet të nxisin nxënësit me nivele të ndryshme social-ekonomike të punojnë së bashku.

☐☐☐☐

f) Nxënësit duhet të mësojnë të kundërshtojnë diskriminimin gjinor.

☐☐☐☐

g) Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga gjinia e tyre

☐☐☐☐

h) Është e rëndësishme të trajtohen në të njëjtën mënyrë nxënësit me nivele të ndryshme social- ekonomike.

☐☐☐☐

i) Një klasë me një përqindje të lartë të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore i pasuron përvojat e të nxënit.

☐☐☐☐

j) Nxënësit duhet të ndjehen të lirë të shprehin orientimet e ndryshme seksuale dhe identitetet e ndryshme gjinore të tyre.

☐☐☐☐

## Arsimimi dhe qëndrueshmëria mjedisore

*Seksioni i mëposhtëm përmban pyetje mbi politikat dhe praktikën e shkollës në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore, me theks te ndryshimet klimatike.*

*"Qëndrueshmëria mjedisore" nënkupton plotësimin e nevojave themelore të së tashmes pa rrezikuar plotësimin e nevojave të brezave të ardhshëm. Ajo përfshin ruajtjen e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e sistemeve ekologjike të Tokës. Ndryshimet klimatike janë një nga kërcënimet kryesore të qëndrueshmërisë mjedisore.*

*"Ndryshimi klimatik" shkon përtej ngrohjes globale, por gjithashtu i referohet një game më të gjerë ndryshimesh, duke përfshirë rritjen e nivelit të detit, tkurrjen e akullnajave, shkrirjen e përshpejtuar të akullit polar dhe ndryshimet në kohën e lulëzimit të luleve/bimëve, si dhe ndikimet e tij në mjedis, ekonomi dhe shoqëri.*

---

## PQ\_48\_sq-AL

**Duke marrë në konsideratë rolin tuaj si drejtor në mbështetjen e edukimit për qëndrueshmërinë mjedisore, jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak dakord

Nuk jam dakord

Dakord

Plotësisht dakord

- a) Është e rëndësishme për mua si drejtor që të trajtoj qëndrueshmërinë mjedisore me kurrikulën.

☐☐☐☐

- b) Kam burimet që më nevojiten për të zhvilluar një strategji të shkollës për përfshirjen e qëndrueshmërisë mjedisore në kurrikul.

☐☐☐☐

- c) Jam i sigurt në mbështetjen që u jap mësuesve, në mënyrë që ata të mund të japin mësim rreth qëndrueshmërisë mjedisore.

☐☐☐☐

- d) Është shumë e vështirë për dikë si unë që të bëj shumë për qëndrueshmërinë mjedisore.

☐☐☐☐

- e) Shqetësohem për ankesat e prindërve dhe kujdestarëve mbi mësimdhënien për ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

- f) E ndjek shqetësimin e nxënësve për të ardhmen e mjedisit tonë.

☐☐☐☐

- g) I nxis mësuesit të fuqizojnë nxënësit të ndërmarrin veprimtari për ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

h) I nxis mësuesit të flasin për ndryshimet klimatike në lëndë të ndryshme.

☐☐☐☐

## PQ\_51\_sq-AL

**Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase janë pengesat e mëposhtme për mësimdhënien që lidhet me ndryshimet klimatike në shkollën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak

Disi

Mjaftueshëm

Shumë

a) Mësuesit mendojnë se ndryshimet klimatike nuk lidhen me lëndën(t) që japin mësim.

☐☐☐☐

b) Mësuesit mendojnë se nxënësit janë tepër të vegjël.

☐☐☐☐

c) Mësuesit nuk dinë mjaftueshëm për ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

d) Mësuesit nuk kanë materialet e nevojshme për të dhënë mësim lëndën.



☐☐☐☐

e) Mësuesit nuk besojnë në ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

f) Bordi drejtues i shkollës dhe/ose ZVA/DRAP/DPAP nuk e lejon këtë.

☐☐☐☐

g) Mësuesit mendojnë se nxënësit kanë mësuar tashmë në shkollë për ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

h) Kurrikula nuk është mjaft fleksibël.

☐☐☐☐

i) Kurrikula nuk e ka të detyrueshme mësimdhënien për ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

j) Vlerësimet nuk përfshijnë ndryshimet klimatike.

☐☐☐☐

---

**PQ\_52\_sq-AL**

**Sa i shqetësuar jeni personalisht për ndryshimet klimatike?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Aspak
  - ☐ Disi
  - ☐ Konsiderueshëm
  - ☐ Shumë
- 

## PQ\_53\_sq-AL

**Ka pasur shumë diskutime për klimën e botës dhe idenë se ajo ka ndryshuar në dekadat e fundit. Cila nga pohimet e mëposhtme i afrohet më shumë mendimit tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje.*

- ☐ Klima e botës nuk ka ndryshuar.
  - ☐ Klima e botës ka ndryshuar kryesisht për shkak të proceseve natyrore.
  - ☐ Klima e botës ka ndryshuar pothuajse në mënyrë të barabartë, për shkak të proceseve natyrore dhe aktivitetit njerëzor.
  - ☐ Klima e botës ka ndryshuar kryesisht për shkak të aktivitetit njerëzor.
  - ☐ Nuk e di.
-

# PQ\_Headline\_Occupational\_Perc\_sq-AL

## Perceptime mbi profesionin

---

### PQ\_54\_sq-AL

**Për sa vite të tjera dëshironi të vazhdoni të punoni si drejtor?**

*Ju lutemi shkruani një numër.*

Vite

---

### PQ\_55\_sq-AL

**Duke menduar për punën tuaj në shkollën tuaj, në cilën masë janë prezent burimet e mëposhtme të stresit në punën tuaj?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak

Disi

Konsiderue -shëm

Shumë

a) Të paturit shumë punë për të bërë për vlerësimin e mësuesve dhe dhënien e komenteve

☐☐☐☐

b) Të paturit shumë punë administrative për të bërë (p.sh., plotësimi i formularëve)

☐☐☐☐

c) Të paturit e detyrave shtesë për shkak të mungesave të personelit arsimor

☐☐☐☐

d) Të qenit përgjegjës për arritjet e nxënësve

☐☐☐☐

e) Mbajtja e disiplinës në shkollë

☐☐☐☐

f) Intimidimi ose abuzimi me fjalë nga nxënësit

☐☐☐☐

g) Mbajtja në hap me kërkesat në ndryshim nga autoritetet si ZVA/DRAP/DPAP

☐☐☐☐

h) Adresimi i shqetësimeve të prindërve/ kujdestarëve

☐☐☐☐

i) Akomodimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

☐☐☐☐

j) Trajtimi i nevojave bazë të shëndetit dhe/ose sigurisë të nxënësve

☐☐☐☐

k) Përshtatja e praktikave të shkollës për shkak të ngjarjeve të papritura (p.sh. fatkeqësitë natyrore, emergjencat/pandemitë e shëndetit publik, krizat humanitare)

☐☐☐☐

---

## PQ\_56\_sq-AL

**Do të donim të dinim si ndjeheni në përgjithësi për punën tuaj? Jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak dakord

Nuk jam dakord

Dakord

Plotësisht dakord

a) Avantazhet e këtij profesioni i tejkalojnë qartë disavantazhet.

☐☐☐☐

b) Nëse do të duhej të vendosja përsëri, do të zgjidhja përsëri të njëjtën punë/pozicion.

☐☐☐☐

c) Do të doja të shkoja në një shkollë tjetër nëse kjo do të ishte e mundur.

☐☐☐☐

d) Jam penduar që vendosa të bëhem drejtor shkolle.

☐☐☐☐

e) Më pëlqen të punoj në këtë shkollë.

☐☐☐☐

f) Pyes veten nëse do të kishte qenë më mirë të zgjidhja një profesion tjetër.

☐☐☐☐

g) Do ta rekomandoja këtë shkollë si një vend të mirë për të punuar.

☐☐☐☐

h) Unë mendoj se profesioni i mësuesit vlerësohet në shoqëri.

☐☐☐☐

i) Unë jam i kënaqur me performancën time në këtë shkollë.

☐☐☐☐

j) Në tërësi, jam i kënaqur me punën time.

☐☐☐☐

## PQ\_57\_sq-AL

### Jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Aspak dakord

Nuk jam dakord

Dakord

Plotësisht dakord

a) Jam i kënaqur me pagën që marr nga puna ime.

☐☐☐☐

b) Përveç pagës, jam i kënaqur me kushtet e kontratës së punës së drejtorit (p.sh., përfitimet, orari i punës).

☐☐☐☐

c) Jam i kënaqur me mbështetjen që marr nga personeli i kësaj shkolle.

☐☐☐☐

d) Kam nevojë për një mbështetje më të madhe nga ZVA/DRAP/DPAP.

☐☐☐☐

e) Unë nuk mund të ndikoj tek vendimet që janë të rëndësishme për punën time.



---

## PQ\_Headline\_End\_sq-AL

Këtu është fundi i pyetësorit.

**Ju falënderojmë shumë për pjesëmarrjen tuaj!**

Ju lutem pasi të keni përfunduar plotësimin e pyetësorit, njoftoni koordinаторin e shkollës tuaj përgjegjës për TALIS 2024.

---

## PQ\_21\_a\_sq-AL

**Gjatë muajit të kaluar, si e frekuentuan nxënësit mësimin në këtë shkollë?**

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

Në asnjë orë mësimi

Në disa orë mësimi

Në të gjitha orët e mësimi

a) Të gjithë nxënësit morën pjesë fizikisht.



☐☐☐

b) Të gjithë nxënësit morën pjesë online.

☐☐☐

c) Disa nxënës morën pjesë fizikisht ndërsa disa të tjerë morën pjesë online.

☐☐☐

---

**PQ\_Start\_sq-AL**



**Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)**

**Studimi Ndërkombëtar mbi Mësimdhënien dhe të Nxënit  
(TALIS) 2024**

---

**PQ\_53\_a\_sq-AL**

## Në përvojën tuaj si drejtues në këtë shkollë, në çfarë mase ndodhin pohimet e mëposhtme?

*Ju lutemi shënoni një zgjedhje në çdo rresht.*

	Aspak	Disi	Mjaftueshëm	Shumë
a) Unë përjetoj stres në punën time.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b) Puna ime më lejon kohë për jetën time personale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c) Puna ime ndikon negativisht në shëndetin tim mendor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d) Puna ime ndikon negativisht në shëndetin tim fizik.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>